




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac – Municipality of Rahovec

KRYETARI I KOMUNËS
Presednik Opštine – Municipal Mayor

**LISTA E VENDIMEVE TË MARRA NGA KRYETARI I KOMUNËS SË RAHOVECIT,
Z. SMAJL LATIFI**

NGA DATA 15.04.2024 DERI MË 19.04.2024

NR.	EMRI I VENDIMIT	NR. I PROTOKOLLIT
1.	Vendim për caktimin e zyrtarit përgjegjës për menaxhimin e Planit Kesh	NRP-02-4086-2024
2.	Vendim	NRP-02-4089-2024
3.	Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës	NRP-02-4090-2024
4.	Vendim	NRP-02-4092-2024
5.	Vendim	NRP-02-4093-2024
6.	Vendim	NRP-02-4094-2024
7.	Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr. prot. 02-3779, i datës 29.01.2024, për caktimin e grupit punues për hartimin e projektbuxhetit të Komunës së Rahovecit për vitin 2025-2027	NRP-02-4096-2024
8.	Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave	NRP-02-4097-2024
9.	Vendim	NRP-02-4098-2024
10.	Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e dëmeve	NRP-02-4099-2024
11.	Vendim për caktimin e Këshillit Organizues për 26 Prillin-daljen publike të UÇK-së në Drenoc	NRP-02-4100-2024
12.	Vendim për qasje në dokumente publike	NRP-02-4102-2024
13.	Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës	NRP-02-4135-2024



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor

REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINETI PREDSEDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 4286 Nr. i faq./Br.str./No.pg 112
Data/Datum/Date 15/4/24
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin zyrtarit përgjegjës për menaxhimin e Planit Kesh

1. Z. Izet Morina, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës: Zyrtar i Lartë për Buxhet dhe Financa, në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, në Komunën e Rahovecit, **CAKTOHET:**

1.1. Zyrtar përgjegjës për menaxhimin e Planit Kesh në Komunën e Rahovecit.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtarit përgjegjës për menaxhimin e Planit Kesh, në Komunën e Rahovecit, janë të përcaktuara në Ligjin Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.
3. Obligohet i lartpërmenduri që të veprojë duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.
4. Ky vendim prodhon efekt juridik deri në përfundim të vitit fiskal 2024.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset z. Izet Morina dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- Z. Izet Morina,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivi.






Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 35 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik dhe nenit 37 të Ligjit Nr. 05/L-068 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 63, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa për punë shtesë dhe punë të paparapara e Menaxherit të Projektit dhe e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë, me Nr. Prot. 1345, të datës: 15.4.2024, në projektin “**Rregullimi i varrezave të dëshmorëve dhe civilëve – Lot 1**” me Nr. të Prokurimit: **623-20-3325-5-2-1**, në shumën prej **13,275.00€ (trembëdhjetë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e pesë euro)**.
2. Ky vendim merret pasi është konstatuar nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë dhe menaxheri i kontratës së projektit dhe verifikimit të gjendjes në terren, se projekti është në fazën përfundimtare dhe për t’u funksionalizuar është e nevojshme që të kryhen punë shtesë.
3. Obligohet Sektori i Prokurimit që t’i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për zhvillimin e procedurave sipas ligjeve dhe akteve nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Zyra e Prokurimit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe menaxheri i projektit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Zyrës së Prokurimit,
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,
- Menaxherit të projektit,
- Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë, dhe
- Arkivit.

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PRESEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 4090 Nr. i faq./Br.str./No.pg 112
Data/Datum/Date 16/4/24
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017 dhe propozimit të Përgjegjësit të Njesisë Kërkuese dhe Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit, kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: “Furnizim dhe vendosje e tabelave për emërtimin e rrugëve, parqeve dhe shesheve”, me numër të kontratës: 623-24-535-1-2-1/C566, si në vijim:
 - 1.1. Jetmir Ukaj, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës: Zyrtar teknik i ndërtimtarisë, në Drejtorinë për Administratë, **CAKTOHET** menaxher i kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
 - 1.2. Albnor Mullabazi, drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
2. Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik, Rregulloren 01/2022 për Prokurimin Publik, Manualin për Përdorim të Modullit për Menaxhimin të Kontratës, si dhe të rregullave të tjera, të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e kontratës. Pas nënshkrimit të kontratës dhe të emërimit të Menaxherit të kontratës (MK), të gjitha përgjegjësitë, përveç kompetencës për të ndryshuar apo ndërprerë Kontratën, barten nga zyra e prokurimit të Menaxherit të Kontratës.
3. Përgjegjësitë e Menaxherit të Projektit/Kontratës janë:
 - 3.1. Menaxheri i kontratës do të menaxhojë obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuar në kontratë;
 - 3.2. Menaxheri i kontratës do të sigurojë se Operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë; dhe
 - 3.3. Menaxheri i kontratës do të bëjë vlerësimin e performancës së kontraktuesve për kontratat nën menaxhimin e tij.
4. Funksionet e Menaxherit të Projektit/Kontratës, janë:
 - 4.1. Në pajtim me Kapitullin V të Rregullores 01/2022 për Prokurimin Publik, pas pranimit të Njoftimit për emërim si menaxher i kontratës, menaxheri i Kontratës, duhet të kyçet në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe duhet të fillojë me fazat e menaxhimit të Kontratës

- nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës. Si fazë e parë, Menaxheri i kontratës brenda afatit, duhet të krijojë Planin për Menaxhim të kontratës, duke përdorur funksionin "Fillimi / mobilizimi i kontratës";
- 4.2. Menaxheri i kontratës, duhet të lexojë kushtet e kontratës dhe të përgatisë Planin e Menaxhimit të kontratës (PMK), i cili duhet të bie dakord me Operatorin Ekonomik;
 - 4.3. Të dorëzojë Planin e aprovuar të Menaxhimit të Kontratës, kërkesën (fletëporosinë) dhe Zotimin e mjeteve në Zyrë të Prokurimit, në mënyrë që zyra e prokurimit të nxjerrë urdhërblerjen;
 - 4.4. Pas pranimit të urdhërblerjes nga zyra e prokurimit, menaxheri i kontratës duhet të vendosë të dhënat në platformën elektronike, të ngarkojë në platformën elektronike urdhërblerjen dhe ta përcjellë përmes platformës tek OE-ja, nga e cila datë fillon numërimi i afatit kohor për liferim;
 - 4.5. Të sigurojë që Operatori Ekonomik i përmbush të gjitha obligimet e performancës, apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.6. Të sigurojë që Operatori Ekonomik e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.7. Të sigurojë që Autoriteti Kontraktues i përmbush të gjitha pagesat dhe obligimet e tjera, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.8. Të sigurojë se ka kontroll adekuat të kostove, të cilësisë, dhe të kohës aty ku është e përshtatshme;
 - 4.9. Të sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së kontratës;
 - 4.10. Të sigurojë që të gjithë regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, të mbahen dhe të arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës, në sistem të prokurimit elektronik;
 - 4.11. Të nxjerrë variacione apo urdhra për ndryshim, nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.12. T'i sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës, Departamentit të Prokurimit dhe ta marrë miratimin;
 - 4.13. Të menaxhojë dorëzimet e procedurave të pranimit të punëve, të mallrave dhe të shërbimeve;
 - 4.14. T'i japë detaje të plota për ndonjë ndërprerje të propozuar të kontratës, Departamentit të Prokurimit; dhe
 - 4.15. T'i dorëzojë raportet mbi progresin ose kompletimin e një kontrate, siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit, ose nga ZKA-ja.
5. Përgjegjësitë e Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës, janë:
 - 5.1. Monitorimi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës; dhe
 - 5.2. Rishikimi, aprovimi dhe procesimi i vlerësimit të performancës së kontraktuesit – vlerësime të propozuara nga menaxherët e kontratave, nën mbikëqyrjen e tij.
 6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- **Menaxheri i kontratës,**
- **Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,**
- **Spektori i Prokurimit,**
- **AQP-ja, dhe**
- **Arkivi.**

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës
Zyrtar Kryesor Administrativ






Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017 dhe nenit 4, paragrafi 4 dhe nenit 14 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, me Nr.1427, të datës 28.4.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa e [REDACTED], me Nr. Protokolli 1367, të datës 16.4.2024, për ndihmë financiare prej [REDACTED] për mbulimin e shpenzimeve në lidhje me studimet e masterit.
2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Zyrës së Kryetarit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Arsyetim

[REDACTED], është duke ndjekur studimet e nivelit master në drejtimin [REDACTED] [REDACTED], në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Duke marrë parasysh se studentja e lartpërmendur, për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike dhe financiare, e ka të vështirë mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimet e tjera eventuale, është e domosdoshme mbështetja financiare për mbulimin e shpenzimeve të shkollimit të saj.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Me vendim të njoftohen:

- [REDACTED]
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine

Municipal Mayor

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEÇ / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEÇ

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 4093 Nr. i faq./Br.str./No.pg 113

Data/Datum/Date 16/4/24

RAHOVEÇ / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës, Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të prokurimit publik, nenit 37 i Ligjit Nr.05/L-068, për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për prokurimin publik, nenit 63 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. Formohet komisioni për vlerësimin e ofertave në projektin “**Furnizimi, montimi dhe mirëmbajtja e kamerave për nevojat e komunës**”, me Nr. Prokurimi: **623-24-1471-1-1-1, Numër i brendshëm 623-24-019-1-1-1, të datës 12.04.2024**, në përbërje prej:
 - 1.1. Arbnor Kabashi, kryesuese,
 - 1.2. Kosovare Gashi, anëtare,
 - 1.3. Meriton Gashi, anëtare.
2. Komisioni ka për detyrë që të bëjë vlerësimin dhe krahasimin e ofertave të tenderit për projektin “**Furnizimi, montimi dhe mirëmbajtja e kamerave për nevojat e komunës**”.
3. Obligohet komisioni që këto punë t’i kryejë duke u bazuar në legjislacionin aktual në fuqi.
4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
5. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

1. Anëtarëve të komisionit
2. Zyrës së Prokurimit, dhe
3. Arkivit



Kryetar i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Orahovac
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – **Municipal Mayor**



Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 4094 Nr. i faq./Br.str./No.pg 113

Data/Datum/Date 16 / 4 / 24

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të prokurimit publik, nenit 37 i Ligjit Nr.05/L-068, për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për prokurimin publik, nenit 63 dhe 92, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

- Formohet komisioni për vlerësimin e ofertave në projektin “**Meremetimi i rrugëve dhe i trotuarve - LOT 2**”, me Nr. Prokurimi: **623-24-2324-5-2-1, Numri i brendshëm: 623-24-026-5-2-1, të datës 12.04.2024**, në përbërje prej:
 - 1.1. Jetmir Ukaj, kryesues,
 - 1.2. Enise Dina, anëtare,
 - 1.3. Egzon Thaqi, anëtare.
- Komisioni ka për detyrë që të bëjë vlerësimin dhe krahasimin e ofertave të tenderit për projektin “**Meremetimi i rrugëve dhe i trotuarve - LOT 2**”.
- Obligohet komisioni që këto punë t’i kryejë duke u bazuar në legjislacionin aktual në fuqi.
- Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
- Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

1. Anëtarëve të komisionit
2. Zyrës së Prokurimit, dhe
3. Arkivit

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine

Municipal Mayor

REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 4096 Nr. i faq./Br.str./No.pg 113

Data/Datum/Date 17/4/24

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 53, paragrafit 3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031, Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023, për Administratë të Hapur në Komunë, nenit 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit me Nr. Prot. 02/3779, i datës 29.1.2024, për caktimin e grupit punues për hartimin e projektbuxhetit të Komunës së Rahovecit për vitin 2025-2027

1. Me këtë vendim, ndryshohet dhe plotësohet vendimi me Nr. Prot. 02/3779, i datës 29.1.2024, për caktimin e grupit punues për hartimin e projektbuxhetit të Komunës së Rahovecit për vitin 2025-2027.
2. Pika 1.10 e vendimit bazik ndryshohet dhe plotësohet, si në vijim:
1.10. Izet Morina, Drejtorja për Buxhet dhe Financa, anëtar.
3. Pikët e tjera të vendimit bazik me Nr. Prot. 02/3779, i datës 29.1.2024, mbesin të pandryshuara.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Me vendimin 02/3779, të datës 29.1.2024, është caktuar grupi punues për hartimin e projektbuxhetit të Komunës së Rahovecit për vitin 2025-2027.

Duke marrë parasysh se Hasan Vuçitërna, i cili me vendimin bazik është caktuar anëtar nga Drejtorja për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, nuk është pjesë e kësaj drejtorie dhe e administratës së Komunës së Rahovecit, është i domosdoshëm zëvendësimi i tij dhe caktimi i Izet Morinës anëtar në këtë grup punues.

Andaj, nga se u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- Izet Morinës,
- Ekrem Bytyqit, kryesues i grupit punues,
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivit.






Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine / Municipal Mayor



Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, të datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave

- Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: “Dezinfektim, deratizim dhe dezinspektim”, me Nr. prokurimi: 623-24-2824-2-2-1 dhe Nr. të brendshëm: 623-24-025-2-2-1, të datës 16.4.2024, në këtë përbërje:
 - 1.1. Jeton Krasniqi, kryesues,
 - 1.2. Kosovare Gashi, anëtare,
 - 1.3. Enise Dina, anëtare.
- Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin e ofertave për projektin “Dezinfektim, deratizim dhe dezinspektim”, me Nr. prokurimi: 623-24-2824-2-2-1 dhe Nr. të brendshëm: 623-24-025-2-2-1, të datës 16.4.2024.
- Obligohet komisioni që këto punë t’i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.
- Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.
- Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Zyrës së Prokurimit, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNES / KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 4098 Nr. i faq./Br.str./No.pg 113
Data/Datum/Date 18 / 4 / 24
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 21 paragrafi 2 pika 2.4 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa e [REDAKTUAR] komuna e Rahovecit me Nr. Protokolit 06-553/01-0015984/24, e dt. 17.04.2024 për ndihmë financiare prej 500.00€ (peseqind euro) për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë (lindjes).
2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

[REDAKTUAR] komuna e Rahovecit me datë 17.04.2024 ka parashtuar kërkesë për ndihmë financiare për lehoni (lindje) pasi që me datë 14.04.2024 ka lindur djal në QKMF “Dr. Fahredin Hoti” në Rahovec.

Marrë parasysh se, e lartpërmendura nuk është në marrëdhënie pune të vazhdueshme dhe me këtë rast e njëjta pas shpenzimeve të lindjes e ka të vështirë përballimin e shpenzimeve të blerjes së gjërave elementare për fëmijën, është e domosdoshme ndihma financiare për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë për [REDAKTUAR] si dhe ndihma për sigurimin e gjërave elementare për foshnjën.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

Me vendim të njoftohen:

- [REDAKTUAR]
- Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLICA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 4099 Nr. i faq./Br.str./No.pg 113
Data/Datum/Date 18/4/24
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), neneve 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për vlerësimin e dëmeve

- Caktohet** komisioni për vlerësimin e dëmit të shkaktuar nga erërat e forta, sipas kërkesës me Nr. Prot. 1164, e datës 2.4.2024, në këtë përbërje:
 - 1.1. Jetmir Ukaj, kryesues,
 - 1.2. Asllan Mazreku, anëtar,
 - 1.3. Diellza Çanta, anëtare.
- Komisioni ka për detyrë që të konstatojë dhe të bëjë vlerësimin e dëmit të shkaktuar nga erërat e forta, sipas kërkesës me Nr. Prot. 1164, e datës 2.4.2024.
- Obligohet komisioni që këto punë t’i kryejë duke u bazuar në legjislacionin aktual në fuqi.
- Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
- Komisioni do të hartojë raport me shkrim për kryetarin e Komunës dhe për Drejtorinë për Mbrotjtje dhe Shpëtim.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Drejtorisë për Mbrotjtje dhe Shpëtim, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 4100 Nr. i faq./Br.str./No.pg 113

Data/Datum/Date 18/4/24

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e Këshillit Organizues për 26 prillin, daljen publike të UÇK-së në Drenoc

1. **Caktohet** Këshilli Organizues për 26 prillin, daljen publike të UÇK-së në Drenoc, në këtë përbërje:
 - 1.1. Fatmir Iska, kryesues
 - 1.2. Afrim Dina, anëtar
 - 1.3. Saranda Sallteku, anëtare
 - 1.4. Nora Boshnjaku, anëtare
 - 1.5. Muharem Morina, anëtar
 - 1.6. Qemajl Krasniqi, anëtar
 - 1.7. Artan Asllani, anëtar
 - 1.8. Shedad Ukaj, anëtar
 - 1.9. Saranda Rama, anëtare
 - 1.10. Feriz Thaqi, anëtar
 - 1.11. Isuf Gashi, anëtar
 - 1.12. Besim Bajrami, anëtar
 - 1.13. Sherif Haxhiu, anëtar
2. Këshilli ka për detyrë të ndërmarr të gjitha veprimet organizative për organizimin dhe mbarrëvajtjen e manifestimit të 26 prillit, daljes publike të UÇK-së në Drenoc.
3. Obligohet Këshilli që këto punë t’i kryej duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.
4. Organizimi dhe ndarja e përgjegjësive për pjesën operative të organizimit të manifestimit i takon kryesuesit të Këshillit Organizues.
5. Këshilli Organizues është i obliguar që t’i raportoj Kryetarit të Komunës mbi ecurinë, mbarëvajtjen dhe shpenzimet e organizimit të manifestimit.
6. Këshilli do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat të arsyeshëm.
7. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e Këshillit Organizues dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.
8. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- Anëtarët e Këshillit Organizues,
- Drejtoria për Kultur, Rini dhe Sport, dhe
- Arkivi.



Kryetari i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 4102 Nr. i faq/Br.str/No.pg 114
Data/Datum/Date 19 / 4 / 24
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës (*Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008*), nenit 21 dhe 26 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 11 të paragrafit 2 të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, nenit 74 dhe nenit 92 të paragrafit 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr:

V E N D I M
Për qasje në dokumente publike

- Miratohet** e bazuar kërkesa me nr. prot. 02/000, e datës 05.04.2024 për qasje në dokumente publike nga Altina Kamberaj dhe i ofrohet qasje e **plotë** në dokumente publike për shpenzimet publike në arsimin publik të realizuara në nivelet e arsimit primar dhe sekondar në Komunën e Rahovecit, si në vijim:
 - Pagat dhe mëditjet;
 - Mallrat dhe shërbimet;
 - Shpenzimet komunale;
 - Subvencionet dhe transferet;
 - Shpenzimet kapitale;
 - Rezervat; dhe
 - Totali i tyre.
- Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Në mbështetje të nenit 10 të paragrafit 1 të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike (QDP), Komuna e Rahovecit ka pranuar kërkesën me nr. prot. 02/000, e datës 05.04.2024 nga Altina Kamberaj për qasje në dokumente publike, për shpenzimet publike në arsimin publik të realizuara në nivelet e arsimit primar dhe sekondar në Komunën e Rahovecit.

Pas shqyrtimit të kërkesës, të njëjtës i ofrohet qasje e **plotë** në dokumente publike, në: pagat dhe mëditje; mallrat dhe shërbime; shpenzime komunale; subvencione dhe transferet; shpenzimet kapitale; rezerva dhe totalin e tyre.

Kërkesa për Qasje në Dokumente Publike është pranuar në mënyrë elektronike.

Komuna e Rahovecit, pas shqyrtimit të kërkesës, si dhe pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të paraqes ankesë në Agjencionin për Informim dhe Privatësi brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data e pranimit të tij.

Vendimi u dërgohet:

- **Blerta Gashi, Zyrtare për shqyrtimin fillestar të QDP,**
- **OJQ “Iniciativa për Progres - INPO”, dhe**
- **Arkivit.**





Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 4135 Nr. i faq./Br.str./No.pg 117

Data/Datum/Date 19/4/24

RAHOVEC / ORAHOVAÇ

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017 dhe propozimit të Përgjegjës të Njesisë Kërkuese dhe Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit, kryetari i Komunës së Rahovecit, merr:

V E N D I M

Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: “Lot 3 – Vazhdimi i ndërtimit të kanalit të kullimit të tokave bujqësore në Ratkoc”, me numër të kontratës: 623-21-2485-5-1-1/C300, si në vijim:
 - 1.1. “P.M.N.” Sh.p.k me adresë në Prishtinë, të cilën e përfaqëson z. Zenun Tolaj, **CAKTOHET** menaxher i kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
 - 1.2. Berat Duraku, Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
2. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik, Rregulloren 01/2022 për Prokurimin Publik, Manualin për Përdorim të Modullit për Menaxhimin të Kontratës, si dhe të rregullave të tjera, të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e kontratës. Pas nënshkrimit të kontratës dhe të emërimit të Menaxherit të kontratës (MK), të gjitha përgjegjësitë, përveç kompetencës për të ndryshuar apo ndërprerë Kontratën, barten nga zyra e prokurimit të Menaxherit të Kontratës.
3. Përgjegjësitë e Menaxherit të Projektit/Kontratës janë:
 - 3.1. Menaxheri i kontratës do të menaxhojë obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuar në kontratë;
 - 3.2. Menaxheri i kontratës do të sigurojë se operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë; dhe
 - 3.3. Menaxheri i kontratës do të bëjë vlerësimin e performancës së kontraktuesve për kontratat nën menaxhimin e tij.
4. Funkcionet e Menaxherit të Projektit/Kontratës, janë:
 - 4.1. Në pajtim me kapitullin V të Rregullores 01/2022 për Prokurimin Publik, pas pranimit të njoftimit për emërim si menaxher i kontratës, menaxheri i Kontratës, duhet të kyçet në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe duhet të fillojë me fazat e menaxhimit të Kontratës nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës. Si fazë e parë, menaxheri i kontratës

- brenda afatit, duhet të krijojë Planin për Menaxhim të Kontratës, duke përdorur funksionin "Fillimi/mobilizimi i kontratës";
- 4.2. Menaxheri i kontratës, duhet të lexojë kushtet e kontratës dhe të përgatis Planin e Menaxhimit të Kontratës (PMK), i cili duhet të bie dakord me Operatorin Ekonomik;
 - 4.3. Të dorëzojë Planin e aprovuar të Menaxhimit të Kontratës, kërkesën (fletëporosinë) dhe Zotimin e mjeteve në Zyrë të Prokurimit, në mënyrë që zyra e prokurimit të nxjerrë urdhërblenjen;
 - 4.4. Pas pranimin të urdhërblenjes nga zyra e prokurimit, menaxheri i kontratës duhet të vendos të dhënat në platformën elektronike, të ngarkojë në platformën elektronike urdhërblenjen dhe ta përcjellë përmes platformës tek OE-ja, nga e cila datë fillon numërimi i afatit kohor për liferim;
 - 4.5. Të sigurojë që Operatori Ekonomik i përmbush të gjitha obligimet e performancës, apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.6. Të sigurojë që Operatori Ekonomik e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.7. Të sigurojë që Autoriteti Kontraktues i përmbush të gjitha pagesat dhe obligimet e tjera, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.8. Të sigurojë se ka kontroll adekuat të kostove, të cilësisë, dhe të kohës aty ku është e përshtatshme;
 - 4.9. Të sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së kontratës;
 - 4.10. Të sigurojë që të gjithë regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, të mbahen dhe të arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës, në sistem të prokurimit elektronik;
 - 4.11. Të nxjerrë variacione apo urdhra për ndryshim, nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.12. Të sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës, Departamentit të Prokurimit dhe ta marrë miratimin;
 - 4.13. Të menaxhojë dorëzimet e procedurave të pranimin të punëve, të mallrave dhe të shërbimeve;
 - 4.14. T'i japë detaje të plota për ndonjë ndërprerje të propozuar të kontratës, Departamentit të Prokurimit; dhe
 - 4.15. T'i dorëzojë raportet mbi progresin ose kompletimin e një kontrate, siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit, ose nga ZKA-ja.
5. Përgjegjësitë e Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës janë:
 - 5.1. Monitorimi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës; dhe
 - 5.2. Rishikimi, aprovimi dhe procesimi i vlerësimit të performancës së kontraktuesit – vlerësime të propozuara nga menaxherët e kontratave, nën mbikëqyrjen e tij.
 6. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me nr. prot. 02/3014, i datës 21.11.2022.
 7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- **Menaxheri i kontratës,**
- **Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,**
- **Spektori i Prokurimit, dhe**
- **Arkivi.**


Smajl Latifi
Kryetar i Komunës
Zyrtar Kryesor Administrativ